

**Aneksi “A”****SHPLLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Shpallja e vendeve të lira të punës do të bëhet nga MM/SHP ose Komandat e forcave/Komandat mbështetëse nëpërmjet QKMB&MSHP-së, e cila përgjigjet për publikimin e vendit të lirë të punës në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në bazë të kërkesave që komandat/strukturat dërgojnë për shpalljen e vendeve të lira të punës QKMB&MSHP bën publikimin e tyre, duke përdorur formatin e dhënë në tabelën 1.

Për shpalljen e një pozicioni konkret me kërkesat e pozicionit ajo do të përdorë formularin nr.1 i cili shfaqet duke klikuar tek emërtimi i pozicionit të shpallur.

| Nr. | Pozicioni i punës           | Struktura e interesuar / Forca | Vendi ku ndodhet | Lloji i kontratës së punës | Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve |            | Afati i aplikimit |            |
|-----|-----------------------------|--------------------------------|------------------|----------------------------|------------------------------------------|------------|-------------------|------------|
|     |                             |                                |                  |                            | Me dosje                                 | Intervista | Fillimi           | Mbarimi    |
| 1.  | Teknik i mesëm(Elektriçist) | RU.Nr. 6690                    | A-045            | 3-mujore                   |                                          |            | 16.09.2026        | 29.09.2026 |

Formulari nr.1 plotësohet nga komandat/strukturat interesuara për shpalljen e vendit të lirë të punës dhe dërgohet zyrtarisht QKMB&MSHP. Kjo e fundit bën publikimet e tij në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes brënda afateve të përcaktuara.

**Formulari nr.1**

|                                                                                                                                                                                                            |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Pozicioni i punës: Teknik i mesëm(Elektriçist)                                                                                                                                                          |
| 2. Kodi i pozicionit : SHP-6690,A-045, B, 04, 003                                                                                                                                                          |
| 3. Reparti /institucioni: Reparti ushtarak nr.6690, ROS                                                                                                                                                    |
| 4. Vendi : Zall-Herr                                                                                                                                                                                       |
| 5. Paga: Sipas VKM nr.326 datë: 31.05.2023 i ndryshuar, paga bazë 53000(pesëdhjetë e tre mijë) lekë, dëmshmëri shëndeti 11500(njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë dhe vështirësi pune 4000(katër mijë) lekë |
| 6. Lloji i kontratës së punës: 3 mujore                                                                                                                                                                    |
| 7. Data e fillimit të aplikimit: 16.09.2026                                                                                                                                                                |
| 8. Data e mbylljes së aplikimit: 29.09.2026                                                                                                                                                                |
| 9. Mënyra e aplikimit: Me kërkesë personale.                                                                                                                                                               |

#### **10. Dokumentet e aplikimit:**

**Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëme:**

- Kërkesën
- Formularin e aplikimit
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në original.
- Dëshmi profesioni nëse ka
- Certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- Raport mjekësor
- Fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- Dëshmi penaliteti
- Vërtetim nga gjykata;
- Vërtetim nga prokuroria
- Librezë pune;
- Jëtëshkrimin (cv)
- Formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al). (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulsri i vetëdeklarimit*).

#### **11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:**

- a) të ketë shtetësi shqipëtare
- b) të jetë jo më pak se 18-vjeç
- c) të gëzoj zotësi të plotë për të vepruar
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotëroj aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara
- e) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- f) të mos jenë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prere për kryerje të një krimi;
- g) të mos jenë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

#### **12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:**

- a) Grada/Titulli: Civil
- b) Arsimi: I mesëm
- c) Kualifikimi:
- d) Trajnimi: kurse/trajnime të ndryshme
- e) Eksperienca në punë: e papercaktuar
- f) Gjuha e huaj: e pa aplikueshme
- g) Kërkesa të tjera specifike: e pa aplikueshme
- h) Niveli i çertifikatës së sigurisë: e pa aplikueshme

#### **13. Përshkrimi i punës:**

Teknik i mesëm (Elektriçist) është personi përgjegjës që kontribon në gadishmërinë teknike të sektorit elektrik, ku përfshihen të gjitha paisjet elektrike si; kabinat elektrike, gjeneratorët, linjat e ndriçimit etje.

**Detyrat kryesore:**

1. Të njoh e të zbatoj në çdo kohë rregullat, urdhërat dhe udhëzimet për përdorimin e aggregateve.
2. Përgatit grafikët e riparimeve dhe të remontëve për të gjitha pajisjet.
3. Të mbajë në gadishmëri të përhershme rrjetin e brendshëm dhe të jashtëm të ndriçimit.

**14.Proçedura e përzgjedhjes së kandidaturave:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 veta. Proçedura e përzgjedhjes së kandidaturave përfshin:

- Përzgjedhjen paraprake;
- Vlerësimin e kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- Intervistën e strukturuar me gojë

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- Vlerësimin e dokumentave të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);
- Intervistën e strukturuar me gojë;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a) 40 pikë, për vlerësimin e dokumentave të kandidatëve;
- b) 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumentave të kandidatëve përfshin:

- a) Vlerësimin e jetëshkrimit (CV)
- b) vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c) vlerësimin e trajnimeve;
- d) vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës.

Pikët totale të vlerësimit të dokumentave ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Dokumentacioni dorëzohet në sekretarinë e ROS-it ( Reparti Ushtarak nr.6690)**

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë faqes së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidati i drejtohen disa pyetje nga antarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pike. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në përputhje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.